Shtresa e ngjeshur perfundimisht nuk duhet te kete siperfaqe jo te njetrajtshme, ndarje midis agrgateve fine dhe te ashper, rrudha ose defekte te tjera.

#### 4.1.4 Tolerancat ne Ndertim

Shtresa nenbaze e perfunduar do te perputhet me toleancat e dimensioneve te dhena me poshte:

##### (a) Nivelet

Siperfaqja e perfunduar do te jete brenda kufijve +15mm dhe +25mm nga niveli i caktuar.

##### (b) Gjeresia

Gjeresia e nenbazes nuk duhet te jete me e vogel se gjeresia e specifikuar.

##### (c) Trashesia

Trashesia mesatare e materialit per cdo gjatesi te rruges matur para dhe pas niveleve, ose nga cpimet e testimeve, nuk duhet te jete me e vogel se trashesia e specifikuar.

#### (d) Seksioni Terthor

Ne cdo seksion terthor ndryshimi i nivelit midis cdo dy pikave nuk duhet te ndryshoje me me shume se 20 mm nga ai i dhene ne vizatimet.

#### 4.1.5 Kryerja e provave (a)

##### Prova Fushore

Me qellim qe te percaktojme kerkesat per ngjeshjen (numrin e kalimeve te pajisjes ngjeshese) provat fushore ne gjithë gjeresine e rruges se specifikuar dhe me gjatesi prej 50m do te behen nga Sipermarresi para fillimit te punimeve.

#### (b) Kontrolli i Proçesit

Frekuenca minimale e kryerjes se proves qe do te duhet per kontrollin e procesit do te jete sic eshte paraqitur ne tabelen 2.

TABELA 2

PROVA	Shpeshtesia e Provave Nje prove cdo:
Materiale	
Dendesia e fushes dhe Perberja e ujit	1500 m <sup>2</sup>
Toleranca e Ndertimeve	
Niveli i siperfaqes	25 m (3 pike per prerje terthore)
Trashesia	25 m
Gjeresia	200 m
Prerje terthore	25 m

#### (c) Inspektimi Rutine dhe Kryerja e Provave te Materialeve

Kjo do te behet per te bere proven e cilesise se materialeve per tu perputhur me kerkesat e ketij seksioni, ose te riparohet ne menyre qe pas riparimit te jete ne perputhje me kerkesat e specifikuara.

## 4.2 Shtresat baze me gure te thyer (cakell)

(Cakell mina- cakell i thyer- cakell makadam)

### 4.2.1 Qellimi dhe definicioni

Ky seksion permban pergatitjen e vendosjen e cakellit te minave, cakellit te thyer dhe atij makadam ne pjesen e themelit. Shtresa “**cakell mina**, i thyer dhe **makadam**”, me fraksione deri 65mm dhe shtresa deri 150 mm quhen “themel me gur te thyer”

Ndryshimet ndermjet tyre jane:

Cakell mina jane materiale te prodhuara me mina ne guoret e aprovuara me fraksione nga 0 deri 65mm.

Cakell i thyer jane materialet te prodhuara me makineri me fraksione te kufizuara 0 deri ne 65mm.

Makadam eshte nje shtrese e ndertuar nga cakell i thyer dhe ku boshlleqet mbushen me fraksione me te imta duke krijuar nje shtrese kompakte.

#### 4.2.2 Materialet

Agregatet (inertet) e perdorura per shtresen baze te perbere prej gureve te thyer do te merren nga burimet e caktuara ne lumenj ose guore. Kjo shtrese nuk do te permbaje material copezues (prishes) si psh. pjese shkembinjsh te dekompozuar ose material argjilor.

Agregati i thyer duhet te plotesoje kerkesat e meposhtme:

(a) VLAREN E COPEZIMIT TE AGREGATEVE

(b) INDEKSI I PLASTICITETIT

Indeksi i Plasticitetit (PI) nuk duhet te tejkaloje 6.

(c) KERKESAT PER NDARJEN (SHKALLEZIMIN)

Shkallezimi do te behet sipas kufijve te dhena ne tabelen -3

Tabela 3

Shkallezimi per shtrese themeli te perbere prej guresh te therrmuar.

Permasat e sites (mm)	Perqindja qe kalon (sipas mases)
50	100
28	84 - 94
20	72 - 94
10	51 - 67
5	36 - 53
1.18	18 - 33
0.3	11 - 21
0.075	8 - 12

Provat per te percaktuar nese materiali prej guresh te therrmuar i ploteson kerkesat e specifikuar te shkallezimit do te behen para dhe pas perzierjes dhe shperndarjes se materialit.

(d) KERKESAT NE NGJESHJE

Minimumi ne vendin me dendesi te thate te shtreses se ngjeshur duhet te jete 98% e Vleres se Proktorit te Modifikuar.

#### 4.2.3 Ndertimi

##### (a) Gjendja

Para se te ndertohet shtresa baze prej guresh te thyer duhet te plotesohen keto kerkesa:

Shtresa poshte saj duhet te plotesoje kerkesat e shtreses ne fjale.

Asnje shtrese themeli prej guresh te thyer nuk do te ngjeshet nese shtresa poshte saj eshte aq e lagur nga shiu ose per arsye te tjera sa te perbeje rrezik per demtimin e tyre.

##### (b) Gjeresia

Gjeresia totale e themelit me cakell (gur te thyer) do te jete sa ajo e dhene ne Vizatimet ose ne udhezimet e Mbikqyresit te Punimevet. (c) Shperndarja

Materiali do te grumbullohet ne menyre te mjaftueshme per te siguruar qe pas ndertimit shtresa ngjeshese te plotesoje te gjitha kerkesat e duhura per trashesine, nivelet, seksionin terthor, dhe densitetin e shtreses. Asnje gropezim nuk do te formohet kur shtresa te kete perfunduar teresisht.

Shperndarja do te behet me makineri ose me krahe.

Trashesia maksimale e shtreses te formuar me gure te therrmuar e ngjeshur me nje proces do te jete sipas vizatimeve.

##### (e) Ngjeshja

Materiali i shtreses se themelit me cakell do te hidhet me dore deri ne trashesine dhe nivelet e duhura dhe plotesisht i ngjeshur me pajisje te pershtatshme, per te fituar densitetin specifik ne tere shtresen me permbajtje optimale lageshtie te percaktuar. Shtresa e ngjeshur perfundimisht nuk do te kete siperfaqe jo te njetrajtshme, ndarje midis agregateve fine dhe te ashper, rrudha ose difekte te tjera.

#### 4.2.4 Tolerancat ne Ndertim

Shtresa baze e perfunduar do te perputhet me tolerancat e dimensioneve te dhena me poshte:

##### (a) Nivelet

Siperfaqja e perfunduar do te jete brenda kufijve +15mm dhe -25mm nga niveli i caktuar, ndryshimi nga shkallezimi i dhene te mos e kaloje 0.1% ne 30 m gjatesi te matur.

##### (b) Gjeresia

Gjeresia e shtresave te themelit nuk duhet te jete me e vogel se gjeresia e specifikuar.

### (c) Trashesia

Trashesia mesatare e materialit per cdo gjatesi te rruges nuk duhet te jete me e vogel se trashesia e specifikuar.

### 4.2.5 Kryerja e Provave Materiale

#### (a) KONTROLLI i PROCESIT

Frekuenca minimale e kryerjes se proves qe do te duhet per kontrollin e procesit do te jete sic eshte paraqitur ne tabelen 4

TABELA - 4

PROVAT	Shpeshtesia e provave nje cdo....
Materialet	
Densiteti ne terren	500 m2
Permbajtja e ujit	
Tolerancat ne Ndertim	
Nivelet e siperfaqes	25m (3 pika per cdo seksion)
Trashesia	25m
Gjeresia	200m
Seksioni Terthor	25m


### 4.3 Shtresa dyshemeje:

#### 4.3.1 Shtrimi i rrugeve kryesore me pllake guri 20x30x5cm









## SPECIFIKIMET BAZË TË TARTANIT

Trashësia minimale 100mm.

### Pjerresia

Nëse përdorni një material të zbrazët pa kullim pjerresia mund të arrijë nga 0% -1% me një sistem kullimi nën sipërfaqe. Kur përdorni një agregat kullues jo të lirë do të ketë një pjerrësi 1% anësore.

### Kompaktesia

Kompleksi 95% -98%

### Kullimi

Rekomandohet drenazhimi nëntokësor.

### Tolerancat

5mm mbi 3m

### Analiza e terrenit

Madhësia agregate	kalon%
25mm	100
19mm	80-100
12mm	70-100
9.5mm	50-100
4.75mm	35-70
2.36mm	25-50
1.18mm	15-35
300um	5-20
75um	0-5

Tartani arrin të njëjtën cilësi si toka në natyrë të sigurt, me avantazhin e të qenit i mbyllur plotësisht.

Me një shtresë gome të mbyllur të lartë dhe një shtresë me ngjyrë uretani për të përfunduar sipërfaqen, tartani ofron një lojë të sigurt, sipërfaqe që mund të pastrohen lehtësisht dhe mirëmbahet.

Avantazhet e tartanit

- Gome e ricikluar
- Nuk ka shtresa të shëmtuara
- Opsionet e pafundme të projektimit
- Ngjyra dhe blendet e personalizuar
- Poroz
- Ofron qasje për njerëzit me aftësi të kufizuara aplikimin ne terren
- Terrenet e lojërave

Aplikimet ne terren

- Terrenet e lojërave
- Parqe dhe kuverta e pishinës
- Zonat e Fitness

50/50 Zi/Kuq

Zi

Blu

Jeshile

Bezh

Kuqe

50/50 Zi/Grihe

50/50 Zi /Blu

50/50 Zi /Jeshile

50/50 Zi /Bezh

#### 4.3.2 Shtrim me zhavor



## **KAPITULLI 5**

### **BETONET**

## **5.1 Te pergjithshme**

Puna e mbuluar nga ky seksion i specifikimeve konsiston ne furnizimin e gjithe kantierit, punen, pajisjet, veglat dhe materialet, dhe kryerjen e te gjitha punimeve, ne lidhje me hedhjen, kujdesin, perfundimin e punes se betonit dhe hekurin e armimit ne perputhje rigoroze me kete kapitull te specifikimeve dhe projekt zbatimin.

Ne fillim te Kontrates Sipermarresi duhet te paraqese per miratim tek Mbikqyresi i Punimeve nje njoftim per metodat duke detajuar, ne lidhje me kerkesat e ketyre Specifikimeve, propozimet e tij per organizimin e aktiviteteteve te betonimit ne shesh (terren). Njoftimi i metodave do te perfshije ceshtjet e meposhtme:

1. Njesia e prodhimit e propozuar
2. Vendosja dhe shtrirja e paisjeve te prodhimit te betonit
3. Metodat e propozuara per organizimin e paisjeve te prodhimit te betonit
4. Procedurat e kontrollit te cilesise se betonit dhe materialeve te betonit
5. Transporti dhe hedhja e betonit
6. Detaje te punes se berjes se kallepeve duke perfshire kohen e heqjes se kallepeve dhe procedurat per mbeshtetjen e perkohshme te trareve dhe te soletave.

## **5.2 Kontrolli i cilesise**

Sipermarresi do te punesoje inxhinier te kualifikuar, te specializuar dhe me eksperience, i cili do te jete pergjegjes per kontrollin e cilesise te te gjitha betonit. Materialet dhe mjeshteria e perdorur ne punimet e betonit duhet te jete e nje cilesie sa me te larte qe te jete e mundur, prandaj vetem personel me eksperience dhe aftesi te plote ne kete kategori punimesh do te punohesohet per punen qe perfshin ky seksion specifikimesh.

## **5.3 Puna pergatitore dhe inspektimi**

Perpara se te jete kryer ndonje proces i pergatitjes se llacit ose betonit, zona brenda armaturave (ose siperfaqe te tjera sipas zbatimit) duhet te jete pastruar shume mire me uje ose me ajer te komprimuar. Cfaredo qe ka te beje me kete proces duhet te pergatitet sic eshte specifikuar.

Asnje proces betonimi nuk duhet te kryhet derisa Mbikqyresi i Punimeve te kete inspektuar dhe aprovuar (ne se eshte e mundur) germimin, masat e marra per mbrojtjen nga kushtet atmosferike, masat per shperndarjen e ujit per freskim dhe staxhionim, armaturat, ndalimin e ujit, fugat ndertimore dhe fiksimin e fundeve dhe masa te tjera, armimin dhe ceshtje te tjera qe duhet te fiksohen, si dhe te gjitha materialet e tjera per betonimin dhe masa te tjera ne pergjithesi. Sipermarresi duhet t'i jape Mbikqyresit te Punimeve njoftime te arsyeshme per te bere te mundur qe ky inspektim te kryhet.

## 5.5 Materialet

### Çimento

a. Çimento Portland e Zakonshme do te perdoret me BS 12 ose ASTM C-150 Tipi II- te ose Tipi V-te. Kjo do te perdoret aty ku betoni nuk eshte ne kontakt me ujera te zeza, tub gazi ose ujerat nentokesore.

b. Çimento Portland Sulfate e Rezistueshme do te perdoret me BS 4027. Kjo do te perdoret per strukturat e betoneve duke perfshire pusetat dhe te gjitha perkatesite e tjera ne kontakt me ujerat e zeza, tubin e gazit ose ujerat nentokesore.

Çimento duhet te shperndahet ne paketa origjinale te shenuara te pa demtuara direkt nga fabrika dhe duhet te ruhet ne nje depo, dyshemeja e te cilit duhet te jete e ngritur te pakten 150mm nga toka. Nje sasi e mjaftueshme duhet mbajtur rezerve per te siguruar nje furnizim te vazhdueshem ne pune, ne menyre qe te sigurohet qe dergesat e ndryshme jane perdorur ne ate menyre sic jane shperndare. Çimentoja nuk duhet ruajtur ne kantier per me shume se tre muaj pa lejen e Mbikqyresit te Punimeve. Çdo lloj tjetër cimento, pervec asaj qe eshte e parashikuar per perdorimin ne pune nuk duhet ruajtur ne depo te tilla. E gjithë cimentoja duhet mbajtur e ajrosur mire dhe cdo lloj cimento, e cila ka filluar te ngurtesohet, ose ndryshe e demtuar apo e keqesuar nuk duhet te perdoret. Fletet e analizave te fabrikave duhet te shoqerojne cdo dergese duke vertetuar qe cimentoja, e cila shperndahet ne shesh ka qene e testuar dhe i ka plotesuar kerkesat e permendura me lart. Me te mberritur, certifikatat e provave te tilla duhen ti kalohen per t'i aprovuar Mbikqyresit te Punimeve. Çimentoja e perfituar nga pastrimi i thaseve te çimentos ose nga pastrimi i dyshemese nuk do te perdoret. Kur udhezohet nga Mbikqyresi i Punimeve, çimento e dyshimte duhet te ristetohet per humbjen e fortesise ne ngjeshje.

### Inertet

#### Te pergjithshme

Me perjashtim te asaj qe eshte modifikuar ketu, inertet (te imta dhe te trasha) per te gjitha tipet e betonit duhet te perdoren duke respektuar STASH-512-78 (Standarti Shqiptar) ose ne perputhje me ASTM C 33 "Inertet e betonit nga burime natyrale". Ato duhet te jene te forte dhe te qendrueshem dhe nuk duhet te permbajne materiale te demshme qe veprojne kunder fortesise ose qendrueshmerise se betonit ose, ne rast te betonarmese mund te shkaterroje kte perforcim.

Materialet e perdorura si inerte duhet te perftohen nga burimet te njohura per te arritur rezultate te kenaqshme per klasa te ndryshme te betonit. Nuk do te lejohet perdorimi i inerteve nga burime, te cilat nuk jane te aprovuara nga Mbikqyresi i Punimeve.

### Inertet e imta

Inertet e imta per kategorite e betonit A, B dhe C (respektivisht M100, M200, M2500) konform STASH 512-78, do te jene prej rere natyrale, gure te shoshitur, ose materiale te tjera inerte me te njejtat karakteristika apo kombinim te tyre. E gjitha kjo duhet te jete

pastruar shume mire, pa masa te mpiksura, cifla te buta e te vecanta, vajra distilimi, alkale, lende organike, argjile dhe sasi te substancave te demtuese.

Permbajtja maksimale e lejueshme e lymit dhe substancave te tjera demtuese eshte 5%. Materialet e marra nga gure te papershtashem per inerte te trasha nuk duhet te perdoren si inerte te imta. Inertet e imta te marra nga guret e shoshitur duhet te jene te mprehte, kubike, te forte, te dendur dhe te durueshem dhe duhet te grumbullohen ne nje platforme per te patur nje mbrojtje te mjaftueshme nga pluhurat dhe perzierjet e tjera.

Shkalla e shperndarjes per inertet e imeta te specifikuara si me lart, duhet te jene brenda kufijve te meposhtem, te percaktuara nga Mbikqyresi i Punimeve.

Masa e Sites	Perqindja qe kalon (peshe e thate)
10.00mm	100
5.00mm	89 ne 100
2.36mm	60 ne 100
1.18mm	30 ne 100
0.60mm	(600 um) 15 ne 100
0.30mm	(300 um) 5 ne 70
0.15mm	(150 um) 0 ne 15

Inertet e imeta per kategorine D te betonit duhet te jene te nje cilesie te mire nga rera e brigjeve. Ajo duhet te jete pastruar nga materialet natyrale e klasifikuar nga me e holla deri tek me e trasha, pa copeza, nga argjila, zgjyra, hirera, plehra dhe cifla te tjera. Nuk duhet te permbaje me shume se 10% te materialit me te holle se 0.10mm (100um) te hapesires ne rrjete, jo me shume se 5% te pjeses se mbetur ne 2.36mm site; i gjith materialit duhet te kaloje neper nje rrjete 10mm.

### Inertet e trasha

Inertet e trasha per kategorite e betonit A, B dhe C do te perbehen nga materiale guri te thyer apo te nxjere ose nje kombinim i tyre, me nje mase jo me shume se 20 mm, dhe do te jene te paster, te forte, te qendrueshem, kubik dhe te formuar mire, pa lende te buta apo te thermueshme, ose copeza te holla te stergjatura, alkale, lende organike ose masa apo substanca te tjera te demshme. Lendet demtuese ne inerte nuk duhet te kalojne me shume se 3 %. Klasifikimi per inertet e trasha te specifikuara sa me siper duhet te jete brenda kufijve te meposhtem:

Masa e sites	Perqindja e kalimit (ne peshe te thate)
50.0 mm	100
37.5 mm	90 ne 100
20.0 mm	35 ne 70
10.0 mm	10 ne 40
5.0 mm	0 ne 5

Inertet e trasha per kategorine D te betonit duhet te jene tulla te thyera te prodhuara prej tullave te cilesise se pare ose grumbulli i tyre, ose nga tulla te mbipjekura. Nuk do te thyhen per perdorim per inerte te imta as tullat e papjekura apo grumbulli i tyre dhe as ato qe jane bere porose gjate procesit te pjekjes. Agregati me tulla te thyera nuk duhet te permbaje gjethe, kashte dhe, rere ose materiale te tjera te huaja dhe ose mbeturina te tjera. Inertet prej tullave te thyera duhet te jene te nje diametri 25-40 mm dhe nuk duhet te permbajne asgje qe te kaloje nepermjet sites 2.36 mm.

### Raportet e inerteve te trasha dhe te imta

Raporti me i pershtatshem i volumit te inerteve te trasha ne volumen e inerteve te imta duhet te vendoset nga prova e ngjeshjes se kubikeve te betonit, por Mbikqyresi i Punimeve mund te urdheroje qe keto raporte te ndryshojne lehtesisht sipas klasifikimit te inerteve ose sipas peshes ne se do te jete e nevojshme, ne menyre qe te prodhohen klasifikimet e duhura per perzjerjet e inerteve te trasha dhe te holla. Sipermarresi duhet te beje disa prova ne kubiket e marre si kampione dhe te shenoje inertet dhe fraksionimin e tyre, perzjerjen e betonit ne fillim te punes dhe kur ka ndonje ndryshim ne inertet e imeta apo te trasha ose ne burimin e tyre te furnizimit. Keta kubike duhet te testohen ne laborator ne kushte te njejta, pervec rasteve te ndryshimeve te vogla ne raportet perkatese te inerteve te imta dhe te trasha (Iart apo poshte) nga raporti me i mire i arritur nga analizat e sites. Kubiket duhet te testohen nga 7 deri 28 dite.

Nga rezultatet e ketyre provave (testeve) Mbikqyresi i Punimeve mund te vendose per raportet e trashesise se inerteve te imta qe duhet te perdoren per cdo perzjerje te mevoneshme gjate zhvillimit te punes ose deri sa te kete ndonje ndryshim ne inerte.

### Shperndarja

Ne kantier nuk do te sillen inerte per tu perdorur derisa Mbikqyresi i Punimeve te kete aprovuar inertet per tu perdorur dhe masat per larjen, etj.

Me tej nga Sipermarresi do te merren kampione ne cdo 75m<sup>3</sup> nen mbikqyrjen e Mbikqyresit te Punimeve, per cdo tip inerti te shperndare ne kantier (terren) dhe te dorezuar perfaqesuesit te Mbikqyresit te Punimeve per provat e kontrolleve te zakonshme. Kosto e te gjitha testeve do te mbulohet nga Sipermarresi.

### Ruajtja e materialit te betonit

Çimento dhe inertet duhet te mbrohen ne cdo kohe nga demtuesit dhe ndotjet. Sipermarresi duhet te siguroje nje kontenier apo ndertese per ruajtjen e cimentos ne shesh. Ndertesa ose kontenieri duhet te jete e thate dhe me ventilim te pershtatshem. Ne se do te perdoret me shume se nje lloj cimentoje ne punime, kontenieri apo ndertesa duhet te jete e ndare ne nendarje te pershtatshme sipas kerkesave te Mbikqyresit te Punimeve si dhe duhet ushtruar kujdes i madh qe tipe te ndryshme cimentoje te mos jene ne kontakt me njera tjetren.

Thaset e cimentos nuk duhet te lihen direkt mbi dysheme, por mbi shtresa druri apo pjese te ngritur trotuari per te lejuar keshtu qarkullimin efektiv te ajrit rreth e qark thaseve.



Çimentoja nuk duhet te mbahet ne nje magazine te perkohshme, pervec rasteve kur eshte e nevojshme per organizimin efektiv te perzjerjes dhe vetem kur eshte marre aprovimi i meparshem i Mbikqyresit te Punimeve.

Agregati duhet te ruhen ne kantier ne hambare ose platforma betoni te padepertueshme te pergatitura posacerisht, ne menyre qe fraksione te ndryshme inertesh te mbahen te ndara per gjithë kohen ne menyre qe perzierja e tyre te ulet ne minimum.

Sipermarresit mund t'i kerkohet te kryje ne kantier procese shtese dhe/ose larje efektive te inerteve ateherë kur sipas Mbikqyresit te Punimeve ky veprim eshte i nevojshem per te siguruar qe te gjitha inertet plotesojne kerkesat e specifikimeve ne kohen kur materialet e betonit jane perzjere. Mbikqyresi i Punimeve do te aprovoje metodat e perdorura per pergatitjen dhe larjen e inerteve.

### Uji per cimento

Uji i perdorur per beton duhet te jete i paster, i fresket dhe pa balte, papasteri organike vegjetale dhe pa kripera dhe substanca te tjera qe nderhyjne ose demtojne forcen apo durueshmerine e betonit. Uji duhet te sigurohet mundesisht nga furnizime publike dhe mund te merret nga burime te tjera vetem nese aprovohet nga Mbikqyresi i Punimeve. Nuk duhet te perdoret asnjehere uje nga germimet, kullimet siperfaqesore apo kanalet e vaditjes. Vetem uje i aprovuar nga ana cilesore duhet te perdoret per larjen e pastrimin e armaturave, kujdesin e betonit si dhe per qellime te ngjashme.

## **5.6 Kerkesat per perzjerjen e betonit**

### Fortesia

Klasifikimet i referohen raporteve te cimentos, inertve te imta dhe inerteve te trasha. Kerkesat per perzjerjen e betonit duhet te konsistojne ne ndarjen propocionale dhe perzjerjen per fortesite e meposhtme kur behen testet e kubikeve;

Klasa e betonit	Fortesia ne shtypje ne N/mm <sup>2</sup> (NEWTON/mm <sup>2</sup> )
	7 dite 28 dite
Klasa A&A (M100) (s)1:1,5: 3	17.00 25.50
Klasa B&B (M200) (s)1:2:4	14.00 21.00
Klasa C&C (M250) (s)1:3:6	6.50 10.00
Klasa D&D (M300) (s)1:6:12	Me pelqimin e Menaxherit te Projektit

Shenim. (s) = Çimento sulfate e rezistueshme.

Raporti uje-cimento

Raporti uje-cimento eshte raport i peshes se cimentos ne te. Permbajtja e ujit duhet te jete efikase per te prodhuar nje perzjerje te punueshme te fortesise se specifikuar, por permbajtja totale e ujit duhet te percaktohet nga tabela e meposhtme:

Klasa e betonit	Max. i ujit te lire/raporti cimento
Klasa A&A (M100) (s)1:1,5:3	0.5
Klasa B&B (M200) (s)1:2:4	0.6
Klasa C&C (M250) (s)1:3:6	0.65
Klasa D&D (M300) (s)1:6:12	Me pelqimin e Mbukqyresit te Pinimeve
Shenim. (s) = Çimento sulfate e rezistueshme.	

### Qendrueshmeria

Raportet e perberesve duhet te jene te ndryshem per te siguruar qendrueshmerine e desheruar te betonit kur provohet (testohet), ne pershtatje me kerkesat e meposhtme ose sipas urdherave te Mbikqyresit te Punimeve.

Perdorimet e betonit	Min&Max (mm)
Seksionet normale te perforcuara te ngjeshura me vibrime, ngjeshja me dore e mases se betonit	25 ne 75
Seksione prej betonarmeje te renda ngjeshura me vibracion, beton i ngjeshur me dore ne pllaka te perforcuara normalisht, trare, kollona dhe mure.	50 ne 100 te

Ne te gjitha rastet, raportet e agregatit ne beton duhet te jene te tilla qe te prodhohen perzjerje te cilat do futen neper qoshe edhe cepa te formave si dhe perreth perforcimit pa lejuar ndarjen e materialeve.

### 5.7 Matja e materialeve

Inertet e imeta dhe te trasha do te peshohen ose te maten me kujdes ne pershtatje me kerkesat e Manaxheri te Projektit. Ato nuk do te maten ne asnje rast me lopata apo karroca dore. Cemento do te matet me thase 50 kg dhe masa e perzjerjes do te jete e tille qe grumbulli i materialeve te pershtatet per nje ose me shume thase.

### 5.8 Metodot e perzjerjes

Betoni duhet te perzjehet ne perzjeresat mekanike te miratuar qe me pare. Perzjersi, hinka dhe pjesa perpunuese e tij duhet te jene te mbrojtura nga shiu dhe era. Inertet dhe cemento duhet te perzjehen se bashku para se te shtohet uje derisa persjerja te fitoje ngjyren dhe fortesine e duhur. Duhet te largohen papastertirat dhe substancat e tjera te padeshirueshme. Uji nuk duhet te shtohet nga zorra apo rezervuare ne menyre te pakujdesshme. i gjithe betoni duhet te perzihet uniformisht ne fabrika moderne perzjerjeje per prodhimin maksimal te betonit te nevojshem per

plotesimin e punes brenda kohes se percaktuar pa zvogeluar kohën e nevojshme për perzjerje. Betoni duhet të perzjehet në perzjerësa betoni për kohezgjatjen e kerkuar për shpërndarjen uniforme të perberësve për të prodhuar një masë homogjene me ngjyrë dhe fortësi por jo më pak se 1-1/2 minute. Perzjerësi duhet të përdoret nga punëtorë të specializuar që kanë eksperiencë të mëparshme në drejtimin e përdorimit të betonit.

Më mbarimin e kohës së perzjerjes, perzjerësi dhe të gjitha mjetet e përdorura do të pastrohen mirë përpara se betoni të mbetur në të këto kohe të forcohet.

Në asnjë mënyrë nuk duhet që betoni të perzjehet me dorë pa miratimin e Mbikqyresit të Punimeve, miratim ky që do të jepet vetëm për sasi të vogla në kushte të vecanta.

### **5.9 Provat e fortësisë gjatë punës.**

Sipërmarresi duhet të sigurojë për qëllimet e provave një set 3 kubikesh për çdo strukturë betoni, përfshirë derdhje betoni nga 1-15 m<sup>3</sup>. Për derdhje betoni me shumë se 15 m<sup>3</sup>, Sipërmarresi duhet të sigurojë të paktën një set shtesë 3 kubikesh për çdo 30 m<sup>3</sup> shtesë. Në se mesatarja e provës së fortësisë së kampionit për çdo porcion të punës bie poshtë minimumit të lejueshëm të fortësisë së specifikuar, Mbikqyresi i Punimeve do të udhëzojë një ndryshim në raportet ose përmbajtjen e ujit në beton, ose të dyja, në mënyrë që Punedhësi të mos ketë shtesë kostojë. Sipërmarresi duhet të përcaktojë të gjitha kampionet që kanë të bëjnë me raportet e betonimit prej nga ku janë marrë. Nëse rezultatet e testeve të fortësisë mbas kontrollit të specimentit tregojnë se betoni i përfutur nuk i plotëson kërkesat e specifikuar ose kur ka prova të tjera që tregojnë se cilësia e betonit është nën nivelin e kërkesave të specifikuar, betoni në vendin, që përfaqëson kampionin do të refuzohet nga Mbikqyresi i Punimeve dhe Sipërmarresi do të levizë dhe të rivendosë masën e kthyer të betonit mbrapsh me shpenzimet e veta. Sipërmarresi do të mbulojë shpenzimet e të gjitha provave që do të bëhen në një laborator që është aprovuar Punedhësit.

### **5.10 Transportimi i betonit**

Betoni duhet të levizet nga vendi i përgatitjes në vendin e vendosjes përfundimtare sa më shpejt në mënyrë që të pengohet ndarja ose humbja e ndonjë perberësi.

Kur të jete e mundur, betoni do të derdhet nga perzjerësi direkt në një paisje që do të bëjë transportimin në destinacionin përfundimtar dhe betoni do të shkarkohet në mënyrë aq të mbledhur sa të jete e mundur në vendin përfundimtar për të shmangur shpërndarjen ose derdhjen e tij.

Në se Sipërmarresi propozon të përdorë pompa për transportimin dhe vendosjen e betonit, ai duhet të paraqesë detaje të plota për paisjet dhe tekniken e përdorimit që ai propozon për të përdorur për të miratuar tek Mbikqyresi i Punimeve.

Në rastet kur betoni transportohet me rreshqitje apo me pompa, kantieri që do të përdoret, duhet të projektohet për të siguruar rrjedhjen e vashdueshme dhe të panderprere në rrepi apo gryke (hinke). Fundi i pjerresisë ose i pompës së shpërndarjes duhet të jete i mbushur me ujë para dhe pas çdo periudhe pune dhe duhet të mbahet pastër. Uji i përdorur për këto qëllime, duhet të largohet (derdhet) nga çdo ambient pune i përhershëm.

## 5.11 Hedhja dhe ngjeshja e betonit

Sipermarresi duhet te kete aprovimin e Mbikqyresit te Punimeve per masat e propozuara perpara se te filloje betonimin.

Te gjitha vendet e hedhjes dhe te ngjeshjes se betonit, duhet te mbahen ne mbikqyrje te vazhdueshme nga pjesetaret perkates te ekipit te Sipermarresit. Sipermarresi duhet te ndjeke nga afer ngjeshjen e betonit, si nje pune me rendesi te madhe, objekt i te cilit do te jete prodhimi i nje betoni te papershkushem nga uji me nje densitet dhe fortesi maximale.

Pasi te jete perzjere, betoni duhet te transportohet ne vendin e tij te punes sa me shpejt qe te jete e mundur, i ngjeshur mire ne vendin rreth perforcimit, i perzjere sic duhet me lopate me mjete te pershtatshme celiku per kallepe duke siguruar nje siperfaqe te mire dhe beton te dendur, pa vrima, dhe i ngjeshur mire per te sjelle uje ne siperfaqe dhe per te ndaluar xhepat e ajrit. Armatura duhet te jete e hapur ne menyre te tille qe te lejoje daljen e bulezave te ajrit , dhe betoni duhet te vibrohet me cdo kusht me mekanizma vibruese per ta bere ate te dendur, aty ku eshte e nevojshme

Betoni duhet te hidhet sa eshte i fresket dhe para se te kete fituar qendrueshmerine fillestare, dhe ne cdo rast jo me vone se 30 minuta pas perzjerjes.

Metoda e transportimit te betonit nga perzjeresi ne vendin e tij te punes duhet te aprovohet nga Mbikqyresi i Punimeve.

Nuk do te lejohet asnje metode qe nxit ndarjen apo vecimin e pjeseve te trasha dhe te holla, apo qe lejojne derdhjen e betonit lirisht nga nje lartesi me e madhe se 1.5m. Kur hedhja e betonit nderpritet, betoni nuk duhet ne asnje menyre te lejohet te formoje skaje apo ane, por duhet te ndalohet dhe te forcohet mire ne nje ndalesa te ndertuar posacerisht dhe te formuar mire per te krijuar nje bashkim konstruktiv efikas, qe eshte ne pergjithesi, ne qoshet e djathta drejt armatimit kryesor. Pozicioni dhe projekti i fugave te tilla, duhet te aprovohen nga Mbikqyresi i Punimeve. Menjehere para se te hidhet betoni tjetër, siperfaqet e te gjitha fugave duhet te kontrollohen, te pastrohen me furce dhe te lahen me llaç te paster. Eshte e keshillueshme qe ashpersia e betonit te jete arritur kur ngjyra behet gri dhe te mos lihet derisa te forcohet.

Para se betoni te hidhet ne ose kundrejt nje germimi, ky germim duhet te jete i forcuar dhe pa uje te rrjedhshem apo te ndenjor, vaj dhe lende te demshme. Balta e qullet dhe materialet te tjera dhe ne rast germim guresh, copesa dhe thermija do te hiqen. Gropa duhet te jete e qullet por jo e lagur dhe duhet te ndermerren masa paraprake per te parandaluar ujerat nenetokesore qe te demtojne betonin e pa hedhur ose te shkaktojne levizjen e betonit.

Aty ku eshte e nevojshme apo e kerkuar nga Mbikqyresi i Punimeve, betoni duhet te vibrohet gjate hedhjes me vibratore te brendshem, te afta per te prodhuar vibrime jo me pak se 5000 cikle per minute. Sipermarresi duhet te tregoje kujdes per te shmangur kontaktin midis vibratorëve dhe perforcimit, dhe te evitoje vecimin e inerteve nga vibrimi i tepert. Vibratorët duhet te vendosen vertikalisht ne beton 500 mm larg dhe te terhiqen gradualisht kur flluckat e ajrit nuk dalin me ne siperfaqe. Nqs, ne vazhdim, shtypja eshte aplikuar jashte armatures, duhet te kihet kujdes i madh qe te shmangët demtimi i betonarmese.

Kur betoni vendoset ne ndalesa horizontale ose te pjerreta te kalimit te ujit, kjo e fundit duhet te zhvendoset duke i lene vendin betonit qe duhet te ngjeshet ne nje nivel pak me

te larte se fundi i ndaleses se ujit para se te leshohet uji per te siguruar ngjeshje te plote te betonit rreth ndaleses se ujit.

### **5.12 Betonim ne kohe te nxehte**

Sipermarresi duhet te tregojë kujdes gjate motit te nxehte per te parandaluar carjen apo plasaritjen e betonit. Aty ku eshte e realizueshme, Sipermarresi duhet te marre masa qe betoni te hidhet ne mengjes ose naten vone.

Sipermarresi duhet te kete kujdes te veçante per kerkesat e specifiuara ketu per kujdesin. Kallepet duhet te mbulohen nga ekspozimi direkt ne diell si para vendosjes se betonit, ashtu edhe gjate hedhjes dhe vendosjes. Sipermarresi duhet te marre masa te pershtatshme per te siguruar qe armimi dhe hedhja e mases per tu betonuar eshte mbajtur ne temperaturat me te uleta te zbatueshme.

### **5.13 Kujdesi per betonin**

Vetem neqoftese eshte percaktuar apo urdheruar ndryshe nga Mbikqyresi i Punimeve, te gjitha betonet do te ndiqen me kujdes si me poshte:

1. Siperfaqe betoni horizontale: do te mbahet e laget vashdimisht per te pakten 7 dite pas hedhjes. Ato do te mbulohen me materiale uje mbajtes si thase kerpi, pelhure, rere e paster ose rrogos ose metoda te tjerra te miratuara nga Mbikqyresi i Punimeve.
2. Siperfaqe vertikale: do te kujdesen fillimisht duke lene armaturat ne vend pa levizur, duke varur pelhure ose thase kerpi mbi siperfaqen e perfunduar dhe duke e mbajtur vazhdimisht te laget ose duke e mbuluar me plasmas.

### **5.14 Forcimi i betonit**

Me perfundimin e germimit dhe aty ku tregohet ne vizatimet ose urdherohet nga Mbikqyresi i Punimeve, nje shtrese forcuese betoni e kategorise D jo me pak se 75 mm e trashe ose e thelle do te vendoset per te parandaluar shperberjen e mases dhe per te formuar nje siperfaqe te paster pune per strukturen.

### **5.15 Betoni i parapergatitur**

Perjashto rastin kur specifikohet ndryshe ketu njesite e betonit te parapergatitur duhet te derdhen ne tipin e aprovuar te cdo kallepi me nje numer individual ose shkronje per qellime identifikimi. Numri i shkronjes duhet te jete ose i stampuar ose e futur ne kallep ne menyre qe cdo njesi e betonuar ne nje kallep te posacem do te deshmoje identifikimin e kallepit. Ne vazhdim data e betonimit te produktit duhet gjithashtu te gervishtet ose lyhet me boje mbi modelin. Pozicioni i shenjës se identifikimit te kallepit dhe dates duhet te jene ne faqen e cila nuk do te ekspozohet ne punen e perfunduar dhe duhet te aprovohet nga Mbikqyresi i Punimeve perpara se betonimi te filloje. Betoni per njesine e parafabrikuar duhet te testohet sic specifikohet ketu dhe duhet te vendoset dhe kompaktohet nga menytrat e aprovuara nga Mbikqyresi i Punimeve.

**KAPITULLI 6**  
**PUNIMET E ELEKTRIKUT**

## 6.1 Kriteret baze

Sistemi I Tokezimit:

- Sistem TNC-S per Panelet Kryesore
- Sistem TNS per nenpanelet

Tensioni nominal Punes ( $U_e$ ) :

- 400 V (L/L)
- 230 V (L/N)

Tensioni nominal Izolimit ( $U_i$ )

- $\geq 690$  V

Tensioni nominal i impulseve ( $U_{imp}$ ) qe durojne pajisjet e tensionit te ulet :

- 24 kV

Tensioni testues i pajisjeve te tensionit te ulet:

1 min. 50 Hz 3500 V

Frekuenca :

- 50 Hz

Sherbimi nominal :

- I panderprere

Renia e tensionit midis burimit dhe ngarkes

- Maksimumi 4 % ne AC (nga klemat e daljes se transformatorit te konsumatori me i larget)

Kosinus fi:

- 0,9 ne furnizimin kryesor

Madhesia e kabllit te neutrit :

- sipas kodeve dhe standarteve
- Sa  $\frac{1}{2}$  e seksionit te fazes per seksione me te medha se 16mm<sup>2</sup>.

- ne seksion te njejte me ate te fazes ne rast furnizimi te pajisjeve qe shkaktoje harmonika (PC, servera, Motorr).

Kapaciteti I ckycjes dhe durimi I lidhjes se shkurter :

- CEI 947.2 P1 (cikel 0 – 3 min. – CO)
- Icu  $\geq 20$  kA Paneli Kryesor
- Icu  $\geq 6$  kA Panelet Shperndarese

Furnizimi me energji elektrike do të realizohet nga paneli i shpërndarjes i vendosur në piken e furnizimit të paracaktuar nga klienti ( Bashkia Tirane ) në bashkpunim me OSHE. Pika e furnizimit është caktuar në kryqezimin e rruges "Myslim Shyri" me atë "Ibrahim Rugova". Duke patur parasysh pozicionin e instalimit kushtet atmosferike dhe goditjet e mundshme mekanike paneli i furnizimit është parashikuar me vetorezine me klase izolacioni IP65. Instalimet elektrike janë me mbrojtje nga prekja direkte dhe indirekte, nga mbingarkesat dhe rrymat e lidhjeve të shkurtera. Përcjellesat dhe kabllojt janë konforme standarteve më të fundit me izolim CPR ( FG16OR16/FG16R16 ) përgjithësisht janë të tipit joperhapës zjarri dhe me çlirim të reduktuar gazesh korozive. Tipi i izolimit është rezistent ndaj lagështirës dhe nxehtësisë, i përshtatshëm për temperaturë pune maksimale deri në 90 gradë Celsius. Kabllojt duhet të jenë një gjatësi pa ndërprerje mes tyre përveç rasteve kur distancat janë më të mëdha se gjatësia maksimale e kablilit, në këto raste parashikohet xhantimi konforme standarteve brenda në kuti shpërndarëse.

## 6.2 Përcaktimi i rrjetit të shpërndarjes së tensionit të ulet dhe rrugekalimeve

Skema e shpërndarjes në 0.4 kV është projektuar sipas sistemit TN-S. Duke patur parasysh natyrën e objektit si park frekuentimi do të jetë i lartë dhe për këtë arsye është vendosur që tokezimi të jetë i përsëritur. Për sistemin e tokezimit do të përdoren elektroda bakri me gjatësi 1.5m të lidhura midis tyre me përcjelles nudo bakri 35mm<sup>2</sup> i cili do të shtrihet përgjatë rrugekalimit të kabujve dhe do të terminojë në kuadrin e furnizimit me energji elektrike.

Secila shtyllë ndricimi do të tokezohej në trupin e saj në pozicion të dukshëm në lartësi minimalisht 10cm nga bazamenti i fiksimit.

Duke marrë parasysh rëndësinë që ka projekti bazuar kjo në pozicionin gjeografik, fluksin e lartë të personave që do të vizitojnë njëkohsisht lulishten, kategorinë e grupmoshave që do ta vizitojnë vecanerisht fëmijet etj. Në projekt kemi parashikuar **rikycjen automatike** të furnizimit me energji elektrike. Në rast të një ndërprerje të energjisë elektrike sipasojë e një faktori kalimtar në rrjetin e furnizimit me energji elektrike është parashikuar që mbas një kohe të caktuar X të tentohet rikycja automatike e energjisë elektrik. Kjo do të sjellë një rritje të sigurtë se furnizimit të energjisë elektrike si dhe rritje të cilësive të furnizimit. Gjithashtu reduktim i kostove në specialist elektrik si dhe shpenzime të tjera shtesë për aksesin deri në vendodhje.

Për përcaktimin e seksioneve të furnizimit të grupeve të ndricimit është marrë parasysh që rënia maksimale e tensionit në fund të linjës nuk duhet të kalojë vlerën prej 4%.

Menyra e shtrirjes së linjave konsiston në vendosjen e kabllorëve në tub korrugat. Pozicionimi i tubave do të bëhet në një thellësi 0.4m dhe do të merret në konsideratë temperatura e tokës prej 20°C.



Percaktimi i koeficientit total jepet si me poshte:

Temperatura e tokes 20°C	K1=1
Thellesia e vendosjes 0.8m	K2=1
Rezistenca e tokes 1.5 K x m/W	K3=1
KTot = K1 x K2 x K3 = 1	

Seksioni i ketyre linjave per ngarkesen dhe gjatesine e konsiderueshme qe kane, do te rezultojne sipas metodës se shpenzimit minimal te bakrit. Per llogaritjen e seksionit do te merret parasysh dhe koeficienti i modaliteti te kalimit te linjes ne rastin konkret ne tub korrugat ne toke. Kalimi i rrjetit të shpërndarjes së tensionit të ulët do të behet ne toke i futur ne tubo pergjate rrugeve te brendshme, nga ku do te behet kalimi per ne kasetat e matjes vendosur në kufijt e pronësisë.

### 6.3 Rrjeti i ndricimit rrugor

Ndricimi i rrugicave të lulishtet parashikon nje ndricim pedonal pergjate tyre me shtyllezim 4 m me ndricues LED. Bazuar ne normat dhe standartet nderkombetare ne parqet publike dhe rrugicat qe sherbejne si rrugekalime ne to parashikohet nje nivel ndricimi minimal prej 20 Lux. Largesia mes shtyllave zbatohet rreth 16 m dhe kjo i pergjigjet nivelit te kerkuar te zones Park . Komandimi i ndricimit rrugor do të behet nepermjet sistemit DALI. Kjo do te thote se ndricimi do te jete i komandueshem ne distance si dhe i dimerueshem. Dimerimi i ndricimit parashikon te behet bazuar mbi fluksin e personave qe po e vizitojne njekohosisht lulishten. Kjo menyre komandimi ndricimi krijon dhe nje vazhdimesi me sheshin Skenderbej dhe menyren e komandimit te ndricimit atje. Dimerimi i ndricimit perben perparesi jo vetem per teknologjine e instaluar dhe mundesit e medha te nderveprimit qe te ofron por gjithashtu do te kete rol dhe ne reduktimin e konsumit te energjise elektrike.

### 6.4 Normat, Ligjet dhe Rregullat

Karakteristikat e pajisjeve, komponentëve dhe materialet e nevojshme për të përfunduar punimet, duhet te jenë në përputhje me karakteristikat e treguara ne kete dokument, duke respektuar ligjet, rregulloret dhe normativat (CEE, UNI, EN, ISO, INAIL, CEI).

Të gjitha pajisjet, komponentët, materialet duhet te jene te reja dhe me cilësi më të mirë në treg, te prodhuara dhe përpunuara nga një profesionist i përshtatshem. Te jenë të destinuara per sherbim dhe karakteristikat e performancës se kerkuar të jene te larta.

Të gjitha materialet dhe furnizimet të jene te pajisura mundësisht me shenjën e cilësisë në përputhje me UNI EN ISO 9001 dhe / ose produkte të certifikuara nga organizata, dhe , ndonëse të dobishme, kanë CE shënuar sipas Direktivave te KE 392/89, të ndryshuar, dhe të jenë në përputhje me dispozitat e dekretit legjislativ Nr 81/2008 në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit të vendosura nga Direktiva.

Makinat dhe pajisjet që ju planifikoni të përdorni do të jenë në përputhje me Direktivën 89/392 EEC dhe 91/368 / / EEC, e ndryshuar, pra furnizimet e pajisjeve dhe kërkesat themelore të përcaktuara në dekretit legjislativ nr. 81 / 2008.

Ky dokument permban kërkesat rregullatore "preferenciale" (standardet evropiane) dhe standardet "te aplikueshme" (standardet e kombeve të tjera).

Në rast të mospërputhjes, mospërputhja dhe/ose e kundërta, janë të paraqitura, sipas rendit: standardet kombëtare, standarteve evropiane, standardet e tjera.

Grushti hidraulik, duke qenë se lind nga një zvogëlim i papritur i shpejtësisë së lengut në lëvizje, shkaktohet në rastin kur koha e mbylljes së organit ndërprerës është më e ulët ose e barabartë me kohën e nevojshme për përhapjen e valës së presionit nga pika e mbylljes deri në rezervuar ose pikën e fillimit të rrjetit dhe kthimin e saj tek organi ndërprerës. Prandaj, koha minimale për të evituar grushtin hidraulik do të jetë:

$$t > \frac{2L}{c}$$

ku:  $t$  = koha e mbylljes së organit ndërprerës (s);

$L$  = gjatësia e rrugës (m);

$c$  = shpejtësia e përhapjes së valës së presionit (m/s).

Në veçanti:

$$c = \frac{C}{\left[1 + \frac{\varepsilon}{E} \times \frac{D}{s}\right]}$$

ku:  $C$  = shpejtësia e zërit në ujë (1.420 m/s në 15 °C);

$\varepsilon$  = moduli i elasticitetit të vëllimit të ujit i barabartë me 2.108 kg/m<sup>2</sup>;

$E$  = moduli i elasticitetit të materialit të tubacionit (kg/m<sup>2</sup>);

$D$  = diametri i brendshëm i tubacionit (m);

$s$  = trashësia (spesori) i tubacionit (m).

Vlerat e  $E$  dhe  $\frac{\varepsilon}{E}$  merren nga tabela:

Materiali	$E$ (kg/m <sup>2</sup> )	$\frac{\varepsilon}{E}$
Çelik	$210 \times 10^8$	0.01
Gizë	$105 \times 10^8$	0.02
HDPE	$0.9 \times 10^8$	2.2
PVC	$3 \times 10^8$	0.7

Lidhur me mbipresionin e krijuar, ai mund të gjendet me formulën e mëposhtme:

$$\rho = \frac{\gamma \times c \times v}{10g}$$

ku:  $\rho$  = mbipresioni (kPa);

$\gamma$  = masa vëllimore e ujit (kg/m<sup>3</sup>);

$c$  = shpejtësia e mbylljes (m/s);

$v$  = shpejtësia e ujit në tubacion përpara mbylljes së saraçineskës (m/s);

$g$  = nxitimi i rënies së lirë, 9.81 m/s<sup>2</sup>.

Masa vëllimore e ujit varion në varësi të temperaturës dhe në 15 °C mund të merret 998.8 kg/m<sup>3</sup>. Nga aplikimi i formulave mund të nxirret se mbipresioni i grushtit hidraulik rritet me zmadhimin e gjatësisë së tubacionit dhe shpejtësisë së lengut si dhe me zvogëlimin e diametrit të tubacionit.

Nga krahasimi i vlerave të  $\varepsilon$  mund të shihet se tubat prej PVC dhe HDPE reagojnë më mirë se materialet rigjide pasi absorbojnë një sasi më të madhe të valës së presionit.

## DIMENSIONIMI I TUBACIONEVE NË PRAKTIKË

Duke patur parasysh implikimet e shumta të humbjeve hidraulike dhe shpejtësisë në tubacione, në praktikë është e rëndësishme të njihen disa rregulla të thjeshta:

- Me qëllim reduktimin e rrezikut të mbipresionit nga grushti hidraulik në minimum, duhet verifikuar që shpejtësia e ujit në tubacione të jetë jo më e lartë se 1 - 2.0 m/s në tubacione me diametër më të vogël se DN 100 dhe mund të arrihet në shpejtësi deri 2.5 m/s në tubacione me diametër DN 100 - DN 200, sidomos kur ata punojnë me ndërprerje.
- Për impiantet e vegjël dhe të mesëm, rënia e presionit midis pikës së furnizimit dhe sprinklerit të instaluar në pozicionin më të disfavourshëm (më larg dhe më lart në raport me pikën e furnizimit), të mbahet brenda vlerës 10 m KU: 3 m KU për humbjet gjatësore të furnizimit (midis pikës së marrjes dhe elektrovalvolës), 3 m KU për humbjet lokale në elektrovalvol dhe 3 m KU për humbjet gjatësore të shpërndarjes (nga elektrovalvola tek sprinklerat). Ngarkesa e mbetur do të kompensojë humbjet hidraulike lokale të rakorderive.

Një formulë mnemonike për një llogaritje të shpejtë orientuese mbi diametrin e duhur është kjo në vijim:

$$D = \sqrt{\frac{Q}{2}}$$

## MENAXHIMI I VADITJES

Objektivi i vaditjes është ruajtja e lagështisë së terrenit, ose e sasisë së ujit e cila progresivisht humbet nga toka. Ky koncept mund të shpjegohet duke patur parasysh dukurinë e evapotranspiracionit (*ET*): është një koeficient i cili shpreh sasinë e ujit të humbur nga sipërfaqja si pasojë e avullimit dhe që përdoret nga bimët për transpirim. Janë të shumtë faktorët që ndikojnë në vlerën e *ET*, por përveç atyre që lidhen me tipin dhe moshën e bimës, ndikim të madh kanë faktorët atmosferikë. Për të nxjerrë të dhënat meteorologjike përdoren matjet që bëhen në stacionet meteorologjike të cilët mund të japin informacione lidhur me kushtet klimatike, informacione të cilat më pas korrigjohen në raport me ndryshimet lokale nga modeli referues.

Nga matja fillestare e evapotranspiracionit potencial *ET<sub>p</sub>*, kalohet në llogaritjen e evapotranspiracionit të kulturës bimore *ET<sub>k</sub>*, duke shumëzuar *ET<sub>p</sub>* me një koeficient ambiental, kulturor ose me ndonjë faktor tjetër përfaqësues i situatës së veçantë: vlera që përftohet më pas mund të aplikohet në kohët e vaditjes së sistemit, i cili do të shpërndajë sasinë e duhur të ujit e nevojshme për bimët. Tabela e mëposhtme jep vlerat e koeficientëve të *ET* për periudhën e verës:

Klima	Milimetra në ditë
E ftohtë me lagështi	2.5 - 3.8
E ftohtë e thatë	3.8 - 5.1
E nxehtë me lagështi	3.8 - 5.1
E nxehtë e thatë	5.1 - 6.4
Shumë e nxehtë me lagështi	5.1 - 7.6
Shumë e nxehtë e thatë	7.6 - 12.7

*E ftohtë*: temperatura maksimale mesatare e mesit të verës më e ulët se 21 °C;

*E nxehtë*: temperatura maksimale mesatare e mesit të verës midis 21 dhe 32 °C;

*Shumë e nxehtë*: temperatura maksimale mesatare e mesit të verës më e lartë se 32 °C;

*E lagësht*: lagështia relative mesatare e mesit të verës më e lartë se 50 %.

Pas përcaktimit të kërkesës hidrike ditore, bëhet verifikimi i pluviometrisë së projektit. Për këtë, merret në shqyrtim një zonë e hapësirës së gjelbër me dimensione të njohura dhe bëhet shuma e prurjeve të të gjithë sprinklerave që janë instaluar në zonë, duke marrë në konsideratë të gjithë prurjen, në se keni i punës është i tëri i përfshirë ose duke u kufizuar me shumën e kuotës së përfshirë. Përftohet kështu një prurje e caktuar e shpërndarë mbi një sipërfaqe me përmasa të njohura.

## **DIMENSIONIMI I REZERVUARIT**

Në rastin kur nuk disponohet sasi uji e mjaftueshme për vaditje, është e nevojshme të parashikohet ndërtimi i një rezervuari, përmasimi i të cilit do të bëhet në varësi të prurjes totale të impiantit.

## **ZGJEDHJA E POMPËS**

Në rastin kur impianti nuk furnizohet nga rrjeti i ujësjellësit për shkak të mungesës së tij në zonë ose prurjes së pamjaftueshme, furnizimi i tij do të sigurohet nëpërmjet zgjedhjes së një pompe centrifugale, e cila do të instalohet brenda një pusi shpimi ose pranë një rezervuari akumulimi. Pompat ndahen në:

1. Pompa sipërfaqësore;
2. Pompa zhytëse.

### **Pompat sipërfaqësore**

Ato ndahen në tre grupe:

- Pompa monoblok me aks horizontal në të cilat trupi i pompës është pjesë përbërëse e karterit të motorit me elikë të montuar në boshtin e motorit, në pozicion horizontal në raport me planin e mbështetjes. Këto pompa janë me dimensione relativisht të mëdha, por janë ekonomike;
- Pompa monoblok me aks vertikal të ngjashme me të parat, por me aksin e motorit në pozicion vertikal në raport me planin e mbështetjes. Janë pompa me dimensione jo të mëdha, kompakte dhe ekonomike, të përshtatshme për përdorime me prevalencë të mesme dhe të lartë;
- Pompa me bazë dhe xhunto në të cilat pompa është e pavarur nga motori dhe lidhet me të nëpërmjet një lidhjeje me xhunto të posaçme. Janë pompa me dimensione të mëdha, kosto të lartë, por me jetëgjatësi të madhe.

### **Pompat zhytëse**

Janë pompa me karakteristika konstruktive për të punuar plotësisht të zhytura. Janë shumë ekonomike dhe me rendimet të lartë. Në rastin kur përdoren në rezervuarë, duhet bërë futja e tyre brenda një tubi për të favorizuar ftohjen.

Disa prej të dhënave karakteristike të një pompe janë:

- Lartësia e thithjes ose niveli dinamik i pusit;
- Prurja e kërkuar dhe presioni i nevojshëm;
- Numri i rrotullimeve të motorit;

- Fuqia : 1250 W
- Modeli : Zhytëse
- Prurja max : 349 Lt/min
- Shtytja max : N/A
- Thithja max : 2 m
- Lartësia max : 13 m

- **Sistemet me disa pompa**

Në kushte të veçanta furnizimi për impiante të mëdha, mund të jetë i nevojshëm përdorimi i stacioneve të pompimit me sistem të përbërë nga disa pompa. Këto sisteme mund të jenë të dy tipeve:

### **Pompa në seri**

Në këtë rast sistemi është i përbërë nga dy pompa, të vendosura njëra pas tjetrës, me prurje të njëjtë, por me prevalenca të ndryshme. Rezultati final i sistemit do të jetë një prurje e barabartë me prurjen e një pompe ndërsa presioni do të jetë i barabartë me shumën e dy presioneve të të dyja pompave: praktikisht pompa e dytë e merr ujin në një kuotë me të lartë e barabartë me prevalencën e pompës së parë.

### **Pompa në paralel**

Në këtë rast të dyja pompat kanë të përbashkët tubacionin e dërgimit në të njëjtin kolektor. Për pasojë, në se kanë prurje të ndryshme dhe prevalencë të njëjtë, rezultati final do të jetë një prurje e barabartë me shumën e të dyja prurjeve, ndërsa prevalenca mbetet e njëjtë me atë të njërës pompë.

### **Komandimi i pompës në impiantin e vaditjes**

Pompa e furnizimit të një impianti vaditës mund të komandohet në dy mënyra të ndryshme:

- Komandim automatik në kaskadë me presostat;
- Komandim automatik në kaskadë me programator.

### **Komandim automatik në kaskadë me presostat**

Pompa, e lidhur me një presostat, fillon funksionimin kur në sistem shfaqet një rënie presioni në rrjet si pasojë e hapjes së një konsumatori si p.sh një elektrovalvol e cila merr sinjalin nga centralina e programimit. Impianti është vazhdimisht nën presion, kështu që në rast të ndonjë difekti të valvolës, edhe për humbje shumë të vogla, pompa qëndron vazhdimisht në punë dhe mund të mbinxehet.

Për të evituar këtë të metë, është i këshillueshëm instalimi i një valvole kryesore, e quajtur Master Valve, e cila bën mbylljen e gjithë impiantit menjëherë pas presostatit: në këtë rast, funksionimi jo korrekt i pompës mund të ndodhë vetëm në se prishen njëkohësisht dy elektrovalvola, gjë që praktikisht është pothuajse e pamundur.

### **Komandim automatik në kaskadë me programator**

Në këtë rast, pompa funksionon vetëm kur centralina e programimit i jep sinjalin për t'u futur në punë. Komandimi i pompës me programator vepron me anën e një releje në të cilën janë lidhur fazat e motorit: pompa fillon punë kur hapet elektrovalvola e parë dhe fiket kur mbaron koha e funksionimit të asaj të fundit. Në këtë lloj funksionimi, rrjeti i

impiantit nuk mund të përdoret nga konsumatorë të tjerë, si rubineta apo hidrante, jashtë hapësirës kohore të vaditjes.

## VADITJA E PEMËVE

Metodat e propozuara janë dy:

**Metoda e vaditjes me pika** quhet ndryshe edhe mikrovaditje, pasi uji shpërndahet nëpërmjet erogatorëve të quajtur pikues me prurje shumë të vogla dhe presione të ulta. Pikuesit ndahen në pikues *on line* dhe pikues *in line*. Të parët janë erogatorë që futen në tuba të vendosur mbi tokë ose në një lartësi të caktuar përgjatë rreshtit të pemëve. Këta erogatorë mund të jenë me buton ose në formë cigareje dhe kanë një prurje 2 - 16 l/min.

Ndërsa pikuesit *in line* janë erogatorë të koekstruduar në brendësi të tubave prej polietileni, vetëpastrues në saje të pranisë së filtrave të vegjël brenda vetë pikuesit. Si në pikuesit *on line*, ashtu edhe në ata *in line*, ekziston mundësia për të patur erogatorë vetëkompensues të cilët me rritjen e presionit, e mbajnë prurjen konstante.

Metoda e vaditjes me pika përbën sot metodën më të përdorur në frutikulturë, në ortikulturë, në serra dhe fidanishte për të cilat kryesore është kursimi i ujit, kursimi i fuqisë punëtore dhe kostot e sistemimit të tokës, mundësia për të kryer ndërhyrje për rritjen e pjellorisë së tokës me vaditje. Në të kundërt, sistemi kërkon, duke qenë se bëhet fjalë për erogatorë me përmasa shumë të vogla, sisteme filtrimi shumë të avancuara që shkojnë nga filtrat e zakonshëm me rrjetë dhe me disqe (idealë për ujërat e puseve), tek më të sofistikuarit filtrat me rërë (idealë për ujërat e liqeneve ose kanaleve të hapur).

**Metoda e vaditjes nëntokë** përbën sistem vaditës më modern në të gjitha drejtimet. Sistemet më efikasë kërkojnë përdorimin e krahëve pikues (pikues *in line*) të mbuluar në numër dhe largësi të ndryshueshme në funksion të tipit të kulturës dhe të kushteve morfologjike të tokës. Sigurisht sistemi bën të mundur një kursim të madh të ujit, pasi në raport me një sistem normal me pika, nuk ka humbje për shkak të avullimit të tokës.

Vaditja nëntokë përbën një sistem shumë efikas për t'u dhënë ujë kulturave edhe në kushtet e disponueshmërisë së pakët të ujit; një e metë është mosrealizimi i tij në toka të pasura me skelet ose ku kryhen punime në thellësi. Po ashtu, një e metë tjetër është mundësia e futjes së rrenjëve dhe thërmijave të dheut që ndodhen rreth pikuesit. Kjo e fundit është zgjidhur në saje të përdorimit të valvolave shfryrëse të ajrit të cilat pengojnë futjen e ajrit dhe me të edhe të llumit përreth, por problemi i futjes së rrenjëve mbetet. Në disa raste, futja e rrenjëve evitohet nëpërmjet përdorimit të herbicideve (kryesisht germicidë) të përzjerë me polietilenin ose të shtuar në impiant.



## 7.2 Sistemi i drenazimit te ujrave atmosferike

### METODA LLOGARITËSE PËR PRURJEN E UJËRAVE ATMOSFERIKE

Prurja meteorike maksimale për dimensionimin e rrjetit të ujërave të bardha, është në përpjestim me sipërfaqet ujëmbledhëse. Norma europiane UNI EN 12056-3 jep, për zonat e ndryshme klimatike europiane vlera të përfshira midis  $0.6 \text{ l/min/m}^2$  dhe  $3.6 \text{ l/min/m}^2$ . Në rastin tonë, do të përdoret vlera njësi  $3.0 \text{ l/min/m}^2$ . Për pasojë:

$$(l/s) 603 \times x = A \phi Q$$

Koeficientët *run-off* do të jenë si më poshtë:

- Çatitë: 0.95;
- Sipërfaqet e gjelbëra: 0.1;
- Sipërfaqet e impermeabilizuara (asfaltet, trotualet, etj.): 0.85.

### TIPI I SISTEMIT TË DRENAZHIMIT

Sistemi i drenazimit i zgjedhur është **drenazhimi linear**.

Sistemi i drenazimit linear, përgjithësisht i përbërë nga kanaleta të parafabrikuara, të zhytura në tokë dhe të mbrojtura nga një mbulesë në formë zgare, kryen mbledhjen dhe evakuimin e ujërave atmosferike nëpërmjet trupit të strukturës drenuese. Praktikisht, në sistemet e drenazhit linear, funksionet e mbledhjes dhe evakuimit të ujërave sipërfaqësore, realizohen nga i njëjti element.

Ky sistem, në thelb i ndryshëm nga ai tradicional (pikësor), bën të mundur përcjelljen e ujit ose fluideve të dala nga proceset industriale, në një vijë mbledhëse të vendosur në tokë, duke shfrytëzuar pjerrësinë e vet ose pjerrësinë e terrenit, duke sjellë një kursim të tubacioneve dhe krahut të punës.

Nga pikëpamja e realizimit, si ekonomike, ashtu edhe e veçorive, vërehet që sistemi i drenazhit linear përmban disa avantazhe:

- Lehtësi në realizimin e sipërfaqes drenuese në raport me sistemin e drenazimit pikësor;
- Vendosja e një rrjeti kanalesh drenues i cili kërkon një vëllim minimal gjermimi;
- Efekt minimal i formës së sipërfaqes drenuese mbi lëvizshmërinë e mjeteve në zonat e trafikut ose mbi lëvizjen e materialeve në zonat industrial;
- Prania e shpërndarë e elementëve drenues bën të mundur realizimin e formave gjeometrike të përshtatshme të cilat mund të integrohen kënaqshëm në aspektin arkitektonik të zonës së interesuar;
- Prania e kufizuar e tubacioneve të mbuluara, të cilat kanë një akses të vështirë dhe të kushtueshëm përsa i përket pastrimit nga lënda e ngurtë e depozituar, e rrit shumë sigurinë e funksionimit të impiantit të drenimit;
- Inspektimi i lehtë dhe i shpejtë i seksionit të defluksit lejon pastrimin e lehtë të këtij të fundit në krahasim me tubacionet e mbuluara.

## **TIPET E KANALEVE DRENUES**

### **Kanale lineare (Tipi 1)**

Kanalet pa pjerrësi të inkorporuar janë të përbërë nga pjesë të parafabrikuara “ modulare “ me lartësi konstante të përdorshëm kryesisht për drenimin e sipërfaqeve të cilat kanë një pjerrësi natyrore të vetën (qoftë edhe minimale), e cila zbrit në drejtim të rrjedhjes së ujit.

### **Kanale me pjerrësi të brendshme (Tipi 2)**

Kanalet me pjerrësi të brendshme janë të përbërë nga pjesë “ të numuruara “ me gjatësi konstante 1 metër dhe pjerrësi 0.5 %. Duke vendosur njëra pas tjetrës të gjitha pjesët e numuruara, përftohen pjesë kanalizimi me gjatësi të përcaktuar dhe pjerrësi lineare të vazhduar.


Përdorimi i këtyre kanaleve bëhet i nevojshëm në rastin kur sipërfaqja e pellgut hidrik që do të drenohet, nuk ka fare pjerrësi natyrore, kështu që është i nevojshëm krijimi i një sistemi drenues efikas, i aftë që të evakujë në një kohë sa më të shkurtër sasi të mëdha uji ose lëngjesh në përgjithësi.

### **Kanale me shkallë (Tipi 3)**

Një lloj tjetër sistem drenazhi pa pjerrësi të brendshme, është ai në të cilin është parashikuar krijimi, nëpërmjet një aksesori të thjeshtë që bën lidhjen e kanaleve, i një sistemi pjerrësie me shkallë, i cili bën të mundur realizimin në të njëjtën linjë drenazhimi, të lidhjeve midis kanaleve me të njëjtën gjerësi, por me lartësi të ndryshme, duke krijuar, në brendësi të kanalit, një disnivel që rrit shumë kapacitetin dhe shpejtësinë e evakuimit të ujit.


Përdorimi i këtyre kanaleve bëhet i nevojshëm në rastin kur sipërfaqja e pellgut hidrik që do të drenohet, nuk ka fare pjerrësi natyrore në drejtim të fluksit të ujit.

## PUSETA DHE KANALIZIMI RRUGOR I UJRAVE TE SHIUT



LEGJENDA	
1	Tub PE ose PVC, $\varnothing = 315$ mm
2	Tub PE ose PVC, $\varnothing = 315$ mm
3	Trupi i pusetës, beton M200
4	Zgarë prej gize
5	Toka natyrore

**SHENIM:**  
Për vendosjen e tubave të drenimit në terren realizohet një kanal me pjerrësi të njëjtë me atë të parashikuar për tubat. Gjerësia e bazës së kanalit do të jetë 40 cm më e madhe se diametri i tubit. thellësia minimale e vendosjes së tubit do të jetë 80 cm kur tubat kalojnë nën rrugë dhe 50 cm kur nuk kalojnë.



LEGJENDA	
1	Shtrati i kanalit
2	Shtresë mbushëse
3	Shtresë mbrojtëse
4	Material mbushës
5	Toka natyrore

**KAPITULLI 8**  
**PUNIME GJELBERIMI**

## 8.1 Peme dhe shkurre dekorative

### 1. Pinus Halepensis / Pishë e egër



lartësia : 15–25 m

hapja e kurores : 10–12 m

### 2. Pinus pinea / Pishë e butë



lartësia : 12–20 m

hapja e kurores : mbi 8 m

### 3. Platanus Orientalis



lartësia : 10–15 m

hapja e kurores : 8 m

4. Tilia Cordata /Bliri



lartesia : 20–40 m  
hapja e kurores : 1/2 e lartesisë

5. Tilia Platyphyllos / Bli



lartesia : 40 m  
hapja e kurores : 15–25 m

6. Tilia Tomentosa / Bliri i Kuq



lartesia : 20–35 m  
hapja e kurores : 8–15 m




7. *Buxus Sempervirens*



8. *Lavandula Intermedia*





Detaj per mbjedhjen e pemeve

Shtresa e pare do te jete me humus me pas dhe i hedhur, shtrese cakelli per perforcimin e rrenjes dhe ne fund do jete toke natyrore


Pemet qe do spostohen do hiqen nga pozicioni ekzistues dhe do rivendosesn me metoden e mbjedhjes se pemeve te reja






**KAPITULLI 9**  
**SHESHET E LOJRAVE**


### 9.1 Shesh lojrash per femije gjithperفشیرهه 01

Kendi i lojrave 01 do te perbehet nga nje strukture metalike me Profile Metalik CHS 219.1X8 ne strukturen kryesore dhe ne pjeset e inkastrimit do te lidhet me Profile Metalik CHS 323.9x6 qe fiksohen me themel betonarme 100x100cm 70cm nen toke.







**SPECIFIKIMI I ANKERIT**




- Plake metalike : 500 X 500 X 30
- Kolona metalike : CHS 219.1x8
- Ankera metalik : 8 M32/Class 8.8
- Gjatesia totale e ankerit 900 mm

**Specifikeme te ankerit**

- Pllake metalike : 500 X 500 X 30
- Kolona metalike : CHS 219.1x8
- Ankera metalik : 8 M32/Class 8.8
- Gjatesia totale e ankerit 900 mm



**SPECIFIKIMI I ANKERIT**



- Pllake metalike : 523.9 X 523.9 X 20
- Kolona metalike : CHS 323.9x6
- Ankera metalik : 8 M32/Class 8.8
- Gjatesia totale e ankerit 900 mm


**Specifikeme te ankerit**


Pllake metalike : 523.9 X 523.9 X 20

Kolona metalike : CHS 323.9x6

Ankera metalik : 8 M32/Class 8.8

Gjatesia totale e ankerit 900 mm





mm    cm

## CHS 323.9x6.3




<b>Gjeometria</b>	
D = 323.9 mm	
T = 6.3 mm	
A = 6290 mm <sup>2</sup>	
A <sub>L</sub> = 1.02 m <sup>2</sup> .m <sup>-1</sup>	
G = 49.3 kg.m <sup>-1</sup>	
<b>Te dhenat e Profilit</b>	
$I_y = I_z = 7.93E+7 \text{ mm}^4$	
$W_{y,el} = W_{z,el} = 4.90E+5 \text{ mm}^3$	
$W_{y,pl} = W_{z,pl} = 6.36E+5 \text{ mm}^3$	
$i_y = i_z = 112 \text{ mm}$	
$I_t = 1.59E+8 \text{ mm}^4$	
$C_t = 9.79E+5 \text{ mm}^3$	



Tabela e llogaritjes se peshes se Hekurit

Shuftrat - specifikimi						
emri	forma dhe përmasat [cm]	Ø	lg [m]	n [copë]	lgn [m]	Napomena
<b>Moduli 01</b>						
		323.9	32.10	1	32.10	
<b>Moduli 02</b>						
		323.9	22.06	1	22.06	
<b>Moduli 03</b>						
		323.9	29.60	1	29.60	
Shuftrat - rirumëtimi						
Ø [mm]	lgn [m]	Pesha njësi [kg/m]		Pesha [kg]		
S 500						
323.9	83.76	49.3		4129.36		

## 9.2 Shesh lojrash per femije gjithperفشیرهه 02

Sheshi per femije 02 me nje siperfaqe me rreze 5m permban 12 shtylla druri me diameter 20 cm dhe lartesi qe varion nga 2-3m qe inkastrohen 1m nentoke dhe nje volum prej guri masiv natyrore i inkastruar ne terren.





### 9.3 Vendosja e shtreses mbrojtëse gjeotekstile - Typar SF 32/33.

Aplikimi i këtij materiali, bëhet direkt mbi shtresën termoizoluese dhe shërben për ta mbrojtur atë nga çakelli që do të hidhet sipër.

Te dhenat teknike:

pesha/sipërfaqe: **110 gr/m<sup>2</sup>**

elasticiteti: **8 kN/m<sup>2</sup>**

Shpim CBR : **1100 N**

Shpimi me kon dinamik : **35 mm**

forca në shtypje : **650 N**

forca në tërheqje : **290 N**

zgjatimi : **45%**

pershkueshmeria  $V_{H50}$  :  **$65 \times 10^{-3}$  m/sek**

Paketimi : **5.2 m x 150 ml.**



**KAPITULLI 10**  
**BASENI UJORE**

## 10.1 Basen uxor

Elementet perberes :

1. Filter me rere kuarcor Brillant 80 me diameter 400 mm, sipas standartit gjerman DIN 19743 dhe 19644. E lidhur me te jane Pompe me bazament plastik me prurje 5 m<sup>3</sup> ne ore me shpejtesi filtrimi V=50m/ore ventil manovrues me 6 pozicione, manometri per matjen e presionit dhe nxjerrjen e ajrit.
2. Rere kuarcore speciale te kokrrizave te madhesive te ndryshme dimensioni 0,4-0,8. Duhet permbushi normen DIN 19623.
3. Skimer i vogel Plastik
4. Diza muri Plastike
5. Tubacionet rakorderi, brryla, materiale ngjitese etj prej PVC-U per pastrimin e fundit. Me ngjyre RAL 7011.
6. Paneli elektrik, me programin perkates per komandimin e impiantit sipas normave VDI
7. Drite RGB PAR 56 12V, PLASTIKE SXLED 270-13, me sinkronizim ngjyrash
8. Impianti automatik I matjes se parametrave te ujit ruajtjes konstante te tyre si dhe dozimit automatik te ph dhe cl Modeli TOPAX.  
Vlefte e PH dh CL sipas standartit DIN 19643-1 Tab 2
9. Kontrolli RGB Master Controller DMX512
10. Decoder DMX 512 deri ne 5 drite
11. Materiale elektrike
12. Kuti shperndarese hermetike speciale
13. Aditiv betoni ne pluhur me baze kristaline per basene / vaska / diga është një përzierje pluhuri e bërë nga komponentë të veçantë hidrofiliqë që, kur shtohet në një përzierje konkrete, zvogëlon depërtueshmërinë e betonit të ngurtësuar.



*\*reference*





Tabela e llogaritjes se shufrave per armimin e basenit ujore

Shufrat - specifikimi						
emri	foma dhe përmasat [cm]	Ø	lg [m]	n [copë]	lg <sub>n</sub> [m]	Napomena
<b>Armimi sipër</b>						
01		8	2.70	1200	3240	
<b>Armimi poshte</b>						
02		8	2.70	1200	3240	
<b>Armimi pergjate basenit</b>						
03		8	120.28	20	2405.6	
Shufrat - rinerërimi						
Ø [mm]	lg <sub>n</sub> [m]	Pesha n <sub>kesi</sub> [kg/m <sup>3</sup> ]	Pesha [kg]			
S 500						
8	8885.6	0.41	3643.096			

**KAPITULLI 11**  
**ELEMENTE URBANE**

## 11.1 Labirinti i kodrave

Plan





Prerje




## 11.2 Shkallaret

### Plan



### Prerje





### 11.3 Lojra tavoline

#### 11.3.1 Fushe shahu 480x480cm e parapergatitur





Moduli i pllakes 60x60x20cm

#### 11.3.1 Tavolina ping-pong-u



## 11.4 Sistemimi i Monumentit te Pavaresise


Fragment baseni monumenti shk. 1:100





## 11.5 Hapesira e dedikuar per kafshe


Krijimi i lodrave te kafsheve me materiale prej druri dhe hekuri.




\*Shembull

Plan

x2 Material druri 18 m<sup>2</sup>  
Hekur Ø 5cm 1.7 ml




Pamje




### Plan

x2 Material druri 24 m<sup>2</sup>  
Hekur Ø 5cm 2.6 ml




### Pamje




### Plan

x2 Material druri 32 m<sup>2</sup>  
Hekur Ø 5cm 2.3 ml




### Pamje




Plan

x2 Material druri 3.6 m2




Pamje




Plan

x2 Material druri 5.2 m2




Pamje




# Plan

x2 Material druri 6.8 m2



# Pamje




# Plan

x2 Trung druri i zgavruar




# Pamje




# Plan

x7 Hekur Ø 10cm 1 ml




# Pamje




# Plan

x2 Suste 6.4 m2  
Hekur Ø 5cm 2.6 ml




# Pamje



## 11.6 Stola

### 11.6.1 Stola tip 01



#### Moduli



*\*Referenca*


### 11.6.2 Stola tip 02

#### Moduli



*\*Referenca*


## 11.7 Kosha mbeturinash



*\*Referenca*

## 11.8 Zgara parkimi per bicikleta

Zgarat e parkimit te bicikletave perbehen nga 20 profile metalike te lidhura ne seri me saldime



**KAPITULLI 12**

**IMPIANTI I MBROJTJES NGA ZJARRI**



## 12.1 Pershkrimi i impjantit MKZ

Impjanti i mbrojtjes nga zjarri i objektit do te realizohet ne baze te standarteve dhe normave lokale si dhe ato te vendeve te Komunitetit European. Sistemi i mbrojtjes kunder zjarrit respekton te gjitha kerkesat e detyrueshme shtetere qe kane te bejne me normat/standartet qe jane ne fuqi aktualisht ne Shqiperi. Gjate procesit te aplikimit te sistemit duhet qe te kontaktohet me autoritetet vendore te MKZSH per te siguruar nje testim dhe aprovim te ketij instalimi.

Duke marre ne konsiderate karakteristikat e nderteses si dhe destinacionin e tij, do te perdoren substanca shuarese si me poshte :


- shuares portabel me pluhur ne ambientet korridore si edhe shuares me anidrid karbonik ne ambientet e vecanta te sherbimit.

Efikasiteti i sistemit te mbrojtjes kunder zjarrit, pa anashkaluar aftesine e operatoreve, do te varet ne nje shkalle te larte nga kapaciteti i ujit dhe presionit te tij, te cilet duhet te jene te mjaftueshem per te shperndare ne hidrante sasine e nevojshme te ujit si dhe te kene mundesine e kontrollit dhe te shuarjes ne kohen e duhur nje zjarr te mundshem. Faktoret percaktues qe jane marre ne konsiderate gjate projektimit jane natyra dhe permasa e zjarrit, madhesia e zones qe do te mbrohet, mundesia e perhapjes me shpejtesia e zjarrit, kerkesat dhe normat sipas UNI 10779 si dhe ato qe jane ne fuqi ne Shqiperi.

## 12.2 Shuaresit portabel te zjarrit

Shuares zjarri portatel, me pluhur 6kg dhe 9kg, te klases 43A-233BC si edhe shuarres zjarri me anidrid karbonik te klases B-8C (per ambientet teknike) do te vendosen ne pozicionet e percaktuara ne projekt. Numri i shuareve portabel dhe pozicioni i tyre ne godine jane percaktuar ne menyre te tille qe te mund te garantohet lehtesia e arritjes tek hidranti.

## 12.3 Hidrand i jashtem DN 80



## **KAPITULLI 13**

### **PUNIMET PER SHTRIMIN E RRJETIT TE VADITJES SE SIPERFAQEVE TE GJELBERTA**

## 13.1 Te pergjithshme

Qellimi i pershkrimnit te kerkesave teknike ne kete kapitull per te gjitha materialet hidraulike (tuba, sprucatore pjese lidhese dhe pjese speciale) eshte sigurimi i materialeve sa me cilesore dhe konform standarteve bashkekohore .

## 13.2 Tubat dhe pjeset speciale hdpe 100

### 13.2.1 Kerkesat e Pergjithshme dhe Standartet Teknike Referuese

Per ndertimin e rrjeteve te vaditjes se siperfaqeve te gjelberta do te perdoren tuba dhe pjese speciale plastike prej materiali Polietileni me densitet te larte (HDPE). Diametrat e tubave do te jene ne funksion te sasise llogaritese te siperfaqeve te gjelberta. Gjatesia e tubave duhet te jete 12 m ose me role deri ne 100 m, kurse diametri dhe spesori duhet te jene sipas te dhenave ne vizatimet teknike. Spesori duhet te jete ne perputhje me kerkesat e projektit per presionin e punes se tubave (PN 6 atm) dhe shkallen e Dimensionimit Standart (SDR = 17 per tuba PE 100 me PN 6 atm). Ovaliteti i tubave nuk duhet te jete me i madh se 1,5 %  
Te dhenat mbi diametrin e jashtem te tubit, presionin, emrin e prodhuesit, standartit qe i referohen, SDR, viti i prodhimit, etj duhet te jepen te stampuara ne cdo tub.

### 13.2.2 Kerkesat Teknike per Materialin e Polietilenit

Materiali i Polietilenit prej te cilit do te prodhohen Tubat dhe pjeset speciale te tyre eshte nje produkt hidrokarbur me formule kimike CH<sub>2</sub>-CH<sub>2</sub>. Ky material duhet te jete i sigurt per shendetin njerezve dhe i aprovuar nga Institucionet perkatese ligjore si IIP, DVGW apo Institute te tjera te afta dhe te aprovuara per testimin e cilesise se materialeve plastike.

Vetite e Materialit te HDPE duhet te jene si me poshte:

- Densiteti > 0,95 g/cm<sup>3</sup>
- Koeficienti i zgjerimit linear 0,13 mm / m \* K
- Konduktiviteti Termik ne 20 grade celsius 0,38W / m \* K
- Indeksi i Rrjedhjes MFI ne 190 grade celsius/50 N 0,4-0,5 g/ 10 min
- Sforcimet 25 N/mm<sup>3</sup>
- Rezistenca Siperfaqesore >10 x 10<sup>14</sup> Omega
- Shkalla e rrjedhshmerise 127 grade celsius
- Terheqja ne thyerje > 600 %

### 13.2.3. Dokumentacioni Teknik Shoqerues

Tubat dhe pjeset Speciale HDPE duhet te jene te shoqeruar me dokumentacionin teknik perkates te kerkuar nga Standartet e mesiperme si:

- Certifikata e Origjines se mallit nga Prodhuesi i Tubave dhe Pjeseve speciale
- Certifikata e Origjines se prodhimit te materialit te PE nga prodhuesi (Borealis, Solvay, BP, Elenac GmbH ose ekuivalent) e shoqeruar me tipin e materialit, llojin dhe te dhenat teknike te pershkruara me siper
- Certifikata e Cilesise ISO 9001/14001 ose ekuivalente
- Certifikata e Testimit te tubave dhe pjeseve speciale ng Prodhuesi i tyre
- Leja Zyrtare per prodhimin e tubave dhe pjeseve speciale per Prodhuesin
- Manual teknik te Tubave dhe te pjeseve speciale te prodhuesit te shoqeruar me manualin e operimit, instalimit, te mirembajtjes si dhe te dhenat teknike te tyre.
- Manualin Teknik te Pajisjeve bashkuese te tyre te shoqeruar me te dhenat e menyres se bashkimit, procesit te ngjitjes, kontrollit dhe testimit gjate procesit te Instalimit.

### 13.2.4. Sprucatorët për vadijtje (Sprinklerat)

Per te realizuar vadijtjen e siperfaqeve te gjelberta qe jane relativisht te vogla do te perdoren sprucatore ter perbere nga trupi i sprucatorit me gjatesi 7.5cm me filetimit 1/2" me koke sprucatori 15van me rreze rrotullimi nga 0-360° me presion 1-3 bar me rreze mbulimi 3.4-4.5m me prurje q=150-850 lt/ore, ose koke sprucatori 10van me rreze rrotullimi nga 0- 360° presion 1-3 bar me rreze mbulimi 2.1-3m me prurje q=150-600 lt/ore te cilat jane me material prej PP/POM (polipropilen dhe polioksimetilen) .Sprucimi realizon vadijtjen ne forme shiu te imet.Kontraktori duhet te siguroje nga tregu ose prodhuesi produktin qe te garantoje parametrat e siperpermendur.



**Koke sprucatori**



**Trup sprucatori**

#### 13.2.4. Transporti dhe Magazinimi

Transporti i tubave dhe pjeseve speciale duhet te behet nga automjete te pershtatshme per transportin e tyre te cilat duhet te jene te pajisura me mbrojtese anesore me lartesi te pakten  $H = 0,6$  m.

Tubat duhet te jene te vendosur drejt, te mbeshtetur tek njeri tjetri dhe te mbuluar me nje mbulesa per mos demtimin e tyre nga rrezet e diellit.

Ngarkimi dhe shkarkimi i tyre duhet te behet me kujdes dhe duke shmangur perplasjet e tyre, sforcimet mekanike apo demtime te tjera te cilat do te jene pergjegjesi e vete Kontraktorit.

Gjate te gjitha kohes se magazinimit, transportimit te tyre ne objekt dhe derin e momentin e instalimit, tubat duhet te jene te mbyllur me tapa plastike fundore te posacme te cilat nuk duhet te hapen dhe te lejojne futjen e ujrave te ndotura, pislleqeve apo materialeve te ndryshme te demshme ne to.

Zona e magazinimit te tubave dhe pjeseve speciale duhet te jete e rrafshet, e paster, pa zhavorre apo gure te mprehte, e rrethuar dhe e mbrojtur. Lartesia e vendosjes se tubave nuk duhet te jete me e madhe se 1 m dhe te gjitha materialet nuk duhet te jene te ekspozuara ndaj rrezeve te diellit.

Gjate te gjitha kohes se magazinimit tubat dhe pjeset speciale te tyre duhet te jene te Mbrojtura nga efektet e naftes, vajit, solventeve apo substancave te tjera kimike.

Periudha maksimale e magazinimit te tyre duhet te jete e percaktuar sipas standarteve nga vete prodhuesi. Tubat dhe pjeset speciale te tyre duhet te hiqen nga Magazina dhe te zbulohen nga mbulesa e paktimit te tyre ne nje kohe sa me te shkurter para instalimit te tyre.

#### 13.2.5. Metodat e bashkimit dhe Kerkesat e Instalimit

Tubat HDPE do te bashkohen me ane te **metodes me Elektrofuzion ose ButFusion** (sipas kerkeses se projektuesit ) duke perdorur pajisjet perkatese te saldimit me elektrofuzion ose butfusion. Kjo lloj ngjitje do te garantoje nje lidhje te sigurve, homogjene dhe jetegjate. Procesi i ngjitjes me elektrofuzion ose butfusion zgjat shume pak minuta. Shkalla e pranimit te rrjedhjes se lenget nga pajisjet e saldimit eshte 0,4 - 1,2 g/ 10 min gje qe lejon ngjitjen e tubave dhe pjeseve speciale PE me fuzion.

Gjithashtu per tubot HDPE me dimensionet OD 20,25,32 dhe 40 bashkimi I tyre me pjeset speciale si T,Bryla,sprucatore apo saracineska mund te behet dhe me bashkues me fileto (me gominat perkatese ) ose adaptor perkates .Qellimi kryesor i cdo lloj bashkimi do te jete siguria ne bashkime,qendrueshmeria e pikave apo nyjeve te bashkimit ndaj levizjeve apo rrjedhjeve te ujit prej tyre.

Cilesia e Instalimit te tubave varet ne nje mase te madhe nga personeli qe do te beje kete ngjitje dhe respektimi prej tyre i kerkesave teknike te ngjitjes. Per kete arsye, specialistet qe do te punojne per ngjitjen e ketyre tubave duhet te jene te pajisur me certifikaten perkatese per kryerjen e ketyre lloj punimeve e cila do te vertetoje kualifikimin dhe trajnimin e tyre.

Instalimi i tubave dhe pjeseve speciale duhet te behet ne kushte te motit normale pa shira, debore, ere dhe ne temperature  $-10 - + 40$  grade celsius.

Gjate ketij procesi, prerja e tubave, pastrimi i tyre, ngrohja e tyre dhe e rakorderive perkatese PE duhet te behet me vegla apo pajisje te posacme qe sigurojne cilesine e kerkuar.

### 13.3 Matja e volumeve

Matjet do te bazohen ne gjatesine e tubave te instaluara. Cdo instalim shtese mbi te dhenat e projektit nuk do te paguhet.

### 13.4 Analiza e cmimit njesi

Cmimi njesi per Tubat, pjeset speciale perfshin furnizimin, transportin ngarkimin, shkarkimin dhe transportin e materialeve dhe pajisjeve te nevojshme gjate instalimit te tyre si dhe vendosjen e te gjitha elementeve te tyre ne menyre te persosur dhe testimin qe do ti behet per presionin e punes me te cilen do te punojne.

### 13.5 Elektropompat

Per te realizuar presionin e nevojshem per rrjetin e vaditjes dhe presionin e nevojshem tek sprucatoret jane parashikuar te instalohen pompa centrifugale vertikale dyshe. Me keto karaktersistika:

$Q= 1 \text{ l/s}$  ,  $H= 20\text{m}$ ,

Gjithashtu se bashku me pompat do te perfshihen edhe furnizimi dhe vendosja e panelit tekomandimit elektrik perkates se bahku me enen e presionit (zgjerimit) me volum  $V= 150$  litra. Pompat duhet te jene brenda standarteve te komunitetit te europian.

#### Modeli i nje pompe centrifugale vertikale

